



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25 Prill 2023

Nr: 409

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 325 ID, TË QENDRËS “QËNDRESA QYTETARE” NDAJ KRYETARIT TË BASHKISË BERAT, MINISTRIT TË BRENDSHËM Z. BLEDI ÇUÇI, SUBJEKTIT ZGJEDHOR PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË DHE DREJTORIT TË PALLATIT TË KULTURËS, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 25 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: Z. Ervin Demo, kryetar i bashkisë Berat
Zj. Arisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat
Drejtorit të pallatit të kulturës “Margarita Tutulani”, Berat
Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 25 Prill 2023

Nr: 409
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të qendres “Qëndresa Qytetare”
për shkelje administrative”

KONSTATOJ:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimi nëpërmjet shkresës datë 10.04.2023, administruar pranë nesh me nr. 3611/1 prot., datë 12.04.2023, me denoncues Qendra “Qëndresa Qytetare”. Pala denoncuese pretendon se ka patur përdorim të burimeve publike, në mbështetje të Partisë Socialiste të Shqipërisë, nga ana e kryetarit të bashkisë bashkisë Berat, z. Ervin Demo.

Në denoncimin regjistruar me nr. **325 ID**, të qendrës “Qëndresa Qytetare” pretendohet si më poshtë vijon:

“Më datë 1 Prill 2023, në ambientet e teatrit të Beratit është zhvilluar takimi me Asamblenë e Zgjeruar të Partisë Socialiste. Në këtë takim, siç evidentohet nga postimet në rrjetet sociale, është prezantuar kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë e Beratit, njëherazi kryetar aktual i kësaj Bashkie dhe është bërë thirrje për mbështetjen e kandidatëve të Partisë Socialiste. Postimi i videos nga ana e Z. Çuçi është shoqëruar me përmbajtjen si më poshtë vijon: “Berat- Në Asamblenë e zgjeruar të Partisë Socialiste prezantuar kandidatin tonë për kryetar Bashkie, Ervin Demo. Zgjedhja më e mirë jo vetëm brenda familjes sonë politike, por për të gjithë qytetarët e Beratit që do t'i japin një mandat të dytë në 14 maj. Çfarë kemi bërë deri më tani është vërtet një punë e madhe. Berati ka hyrë në një rrugë të pakthyeshme transformimi dhe ne kemi përgjegjësinë historike të çojmë përpara punët e projektet që presin. Çdo votë për Ervin Demon, çdo votë për Partinë Socialiste dhe skuadrën tonë në Këshillin Bashkiak. #MeNjerëzitPërNjerëzit #PërBeratin #MeErvinin #PS

Gjatë këtij takimi, Ministri i Brendshëm iu është drejtuar anëtarëve të Asamblesë së Zgjeruar si vijon: “Por nga sot duhet të fokusohemi në një objektiv: një rezultat historik në mazhoritar për kryetarin tonë Ervinin dhe një rezultat historik, dhe këtu është më e vështirë se e para, për Këshillin Bashkiak. Nuk duhet të lemë asnjë votë të na ikë kot.” Ndërsa Z. Ervin Demo, duke përdorur cilësinë dhe funksionin e tij si Kryetar, ka kërkuar mbështetje për Partinë Socialiste dhe për atë vetë, si kandidat në zgjedhjet e 14 majit pasi shprehet se: “Në fushatë ne do të dalim për atë që përfaqësojmë si force politike, unë si kandidat duke iu referuar punëve që kemi bërë këto katër vite”.

Në postimin e tij në “Facebook”, Z. Demo shprehet: “Në këto 4 vite kemi nisur transformimin e Beratit për ta çuar aty ku e meriton. Unë e kam vënë bastin me punën, për ta bërë Beratin shtëpinë e ngrohtë të të gjithë banorëve të tij. Tani është koha për të besuar tek e ardhmja që po ndërtojmë dhe te projektet që na presin. I jam mirënjohës Partisë Socialiste të Beratit, Drejtuesit të qarkut Z.Bledi Çuçi dhe Kryetarit të partisë socialiste dhe kryeministrit Z.Edi Rama për besimin dhe mbështetjen pa asnjë dyshim për punët dhe idetë tona. Jam krenar për mundësinë e dhënë për t’ju përfaqësuar dhe shërbyer në këto 4 vite dhe pres me padurim të vazhdojmë sërish bashkë me më shumë dëshirë, pasion dhe dashuri për Beratin #PërBeratin #Zgjedhjet14Maj”

Siç rezulton nga më sipër, aktiviteti në fjalë është zhvilluar me praninë e qytetarëve, më konkretisht me praninë e anëtarëve të asamblesë të Partisë Socialiste në Berat. Megjithë natyrën publike të aktivitetit, Bashkia e Beratit, të paktën për aq sa është verifikuar nga ana jonë, nuk e ka raportuar këtë aktivitet në ndërfaqen e raportimeve. Megjithatë, nëse gjatë hetimit administrativ do të provohet kjo shkelje, atëherë do të kërkojmë dhe ndëshkimin e personave përgjegjës. "

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në vijim të procedurës administrative, fillova hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Denoncuesi pretendon se nëpërmjet kryerjes së aktivitetit të mësipërm është përdorur një burim publik në mbështetje të subjekteve zgjedhore, referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020.

Më datë 18.4.2023 bashkisë Berat i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 19.4.2023, bashkia Berat bën me dije se "Në zbatim të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022 të Presidentit të Republikës "Caktimin e datës 14 Maj 2023, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", për zhvillimin sa më normal të fushatës zgjedhore, për të gjitha forcat politike të cilat marrin pjesë në këtë garë elektorale, bashkia Berat ka vendosur në dispozicion shfrytëzimin e ambienteve (sallës kryesore) të Pallatit të Kulturës "Margarita Tutulani", për të gjitha këto forcat politike. Duke qenë përpara faktit se, në qytetin e Berat nuk ka asnjë ambient tjetër të përmasave që ka salla kryesore e Pallatit të Kulturës "Margarita Tutulani" dhe asnjë ambient tjetër të përshtatshëm për realizimin e takimeve, me pjesëmarrje të konsiderueshme, është vendosur që ky ambient t'i vihet në dispozicion të gjitha forcave politike që do të kërkojnë të zhvillojnë takime elektorale të këtyre përmasave.

Për sa më sipër, theksojmë në po këto ambiente janë përdorur edhe nga kandidati tjetër në garën e zgjedhjeve vendore 2023 për qytetin e Beratit, z. Zija Ismaili i koalicionit "Bashkë fitojmë", me praninë e z. Sali Berisha në këtë takim. Ky takim është pasqyruar në adresat

zyrtare të tyre. (Më poshtë linku i kandidatit për kryetar bashkie të qytetit Berat dhe kryetarit të forcës politike që ai përfaqëson në këto zgjedhje)

Në faqen zyrtare të z. Zija Ismaili, linku:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02mTaxU4qJZqE9BrZy1CUdGQDumimM5GMpK23v6uGcVeHYsmPBUdHnmRbVD5oE3avLI&id=100087934823134&mibextid=Nif5oz

Në faqen zyrtare të z. Sali Berisha, linku:

<https://fb.watch/j-odPëDsRT/?mibextid=Nif5oz>

Pra theksojmë edhe një herë se kjo praktikë do të ndiqet edhe në vazhdimësi, për shkak të pamundësisë për të përdorur ambiente të tjera të përshtatshme për realizimin e këtyre takimeve, nga të gjitha forcat politike në garë për zgjedhjet vendore 2023.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 25.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

I pranishëm në këtë seancë ishte përfaqësuesi i autorizuar i qendrës “Qëndresa Qytetare” z. Dhimitër Zguro, ndërsa nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Berat.

Në seancën publike, përfaqësuesi i qendrës “Qëndresa Qytetare mbajti të njëjtin qëndrim si në denoncimin e depozituar si dhe ka theksuar edhe një herë se përdorimi i ambienteve të Pallatit të Kulturës “Margarita Tutulani” përbën shkelje të parashikimeve ligjore në fuqi, pasi përdorimi i burimeve publike për qëllime zgjedhore nuk mund të legjitimohet në asnjë rast.

Në përfundim të hetimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve, rezultoi se:

Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes hetimore u provua se, Pallati i Kulturës “Margarita Tutulani”, është vënë në dispozicion të subjekteve të ndryshme zgjedhore, ambientet e Pallatit të Kulturës për kryerjen e aktiviteteve elektorale, kjo e provuar nëpërmjet link me foto të bashkëlidhur elektronikisht në adresë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga pala e denoncuar. Vënia në dispozicion e Pallatit të Kulturës “Margarita Tutulani”, nga ana e përgjegjësit të këtij objekti është bërë pa qëllim favorizimi të ndonjë subjekti politik. Nga sa u provua nga fotot edhe nga pohimet e përfaqësuesit të Bashkisë Berat, pallati i kulturës u është vënë në dispozicion subjekteve zgjedhore në mënyrë të paanshme sipas kërkesave të tyre.

Neni 91, i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, shprehet se **“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike”**. Ligji ndalon vendosjen e institucioneve publike në favor të subjekteve zgjedhore për të garantuar një fushatë të barabartë për garuesit, por parashikon edhe përjashtime të përligjura nga ky

ndalim. Në këtë rast denoncuesi kishte si qëllim të nxirrte në pah favorizimin që i është dhënë kandidatit të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, z. Ervin Demo duke përdorur institucionin publik për fushatën e tij elektorale. Provat shtesë të vëna në dispozicion ku provohet se pallati i kulturës është vënë në dispozicion edhe për subjektet e tjera, objekti i shqyrtimit administrativ, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, krijon bindjen se nuk ka favorizim të një subjekti zgjedhor në veçanti. Vetë dispozita parashikon mundësinë e “rasteve të parashikuara nga ligji” kur mund të lejohet përdorimi i burimeve publike. Ambientet, **që për shkak të funksionit** dhe mundësive akomoduese që ofrojnë dhe **kur dhënia në përdorim, bëhet sipas kushteve dhe kritereve të caktuara**, mund të përdoren nga subjektet zgjedhore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se përdorimi i ambienteve të Pallatit të Kulturës “Margarita Tutulani”, për shkak të funksionit mund të përdoren nga subjektet zgjedhor. Për sa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj kryetarit të bashkisë Berat dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, duke mos konstatuar shkeljen e pikës 1 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Lidhur me pretendimet për ndalimin mbi ministrat dhe një sërë funksionarësh publikë për të marrë pjesë në veprimtari publike të ndaluara, në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, ky aktivitet nuk përbën veprimtari publike të ndaluar.

Vlerësojmë se pjesëmarrja e z. Bledi Çuçi nuk lidhet domosdoshmërisht me funksionet e ministrit. Aktiviteti i zhvilluar nuk është aktivitet i institucionit të bashkisë Berat, por një aktivitet i mirfilltë politik, ku është prezantuar dhe kandidati për kryetar për zgjedhjet e 14 Maji 2023. Ndër të tjerash, ministri është edhe funksionar politik, i cili mund të zhvillojë veprimtari politike, përtej detyrës së ministrit. Mbështetur edhe në provat dhe faktet e administruara vihet re se, në ligjeratën e tij z. Çuçi shprehet për familjen politike dhe jo mbi detyrat funksionale të ministrit.

Veprimtaria e kryer në ambientet e Pallatit të Kulturës “Margarita Tutulani”, Berat, është një veprimtari me karakter politik/elektoral dhe jo me karakter publik në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor **“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”**, detyrimin për raportim e kanë vetëm institucionet publike, për veprimtaritë që ato kryejnë. Për aq kohë sa aktiviteti i mësipërm, nuk është organizuar nga bashkia Berat, këto veprimtari nuk kanë detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve .

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të materialeve u vlerësua se aktiviteti i zhvilluar nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenet 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 dhe 171/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrative dhe moskonstatimin e shkeljes për:
 - a) zj Arisa Toska, person përgjegjës për raportim;
 - b) z. Ervin Demo, kryetar i bashkisë Berat;
 - c) Drejtorit të Pallatit të Kulturës “Margarita Tutulani”
 - d) Parita Socialiste e Shqipërisë, subjekt zgjedhor.
2. Moskonstatim i shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 4
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
I.Horanlliu _____
M.Koja _____
A. Lamçe _____
Y.Merkaj _____

Data: 25 Prill 2023

Nr: 409
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të qendres “Qëndresa Qytetare” për shkelje administrative.”